

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA “Opsion Group” SHPK

Sot me date 23/01/2024 , une ortakja e vetme: Znj. Zehra Gorani, e ditëlindjes 22.10.1978, lindur ne Durres, banues ne Durres, e pajisur me leternjoftim me nr personal H86022053M.

Ne baze te ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 ‘Per tregtaret dhe shoqerite tregtare’ dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 ‘Per qendren kombetare te regjistrimit ‘ kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “Opsion Group” SHPK.

Neni 1 :

Emertimi i shoqerise

Shoqeria do te quhet “Opsion Group” SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti , ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si edhe ligjit per QKR.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Shoqeria do te kete seline e saj ne Lagjja 13, Rruga Pavarësia, Nr pasurie 46/558/ND-N2, Zona Kadastrale 8518,Durres. Shoqeria mund te krijoje dege , filiale , zyra përfaqësim ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjisllacionin shqiptar.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj: Tregtim me shumicë e pakicë dhe import-eksport të: mallrave të ndryshme ushqimore, industriale, bujqësore e blegtorale, agjensi biletash (detare,ajerore, tokesore) si edhe cfardo lloj operacioni tregtar,financiar,qe do te konsiderohet I nevojshem ose I dobishem per arritjen e objektivit te shoqerise.

Neni 4

Kapitali i shoqërisë

Kapitali i shoqërisë “Opsion Group” shpk do te jete 100.000 Leke .

Ky kapital perbehet nga 1 (nje) kuote dhe zoterohet ne masen 100 % nga ortakja e vetme Zehra Gorani.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar .

Neni 6

Organet e shoqerise

1.Asambleja e përgjithshme

2.Administratori

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise do te jete Znj. Zehra Gorani, e ditëlindjes 22.10.1978, lindur ne Durres, banues ne Durres, e pajisur me leternjoftim me nr personal H86022053M, e cila emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte riparteritje te ketij afati.

NENI 7

Shperndarja e fitimit vjetor të shoqerise

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit ne raport me vleren e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime të tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

Prishja e shoqerise.

Shoqeria priset :

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,

b)me vendim te asamblese se pergjithshme,

c) me hapjen e procedurave te falimentimit,

ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "OKR",

d) me vendim te giykates,

dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi I shoqerise.

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emerone nje likuidator, I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e progesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise,likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje

e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10

Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

Ortaku Themelues i Shoqerise "Opsion Group" SHPK

Zehra Gorani

ZEHRA GORANI

